



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 prill 2021
Nr. Ref.:RK 1741/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI105/19

Parashtrues

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-II.-12-0126, të 14 shkurtit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar me autorizim nga Naser Krasniqi, këshilltar i lartë ligjor në këtë Agjenci.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së), AC-II.-12-0126, të 14 shkurtit 2019, në ndërlidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2021/2007, të 29 korrikut 2007.
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 21 shkurt 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me anë të të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe paragrafin 3 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 21 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 26 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 17 korrik 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të dorëzojë para Gjykatës dokumentet si në vijim: 1. Autorizimin për përfaqësuesin ligjor; 2. Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2021/2007, të 29 korrikut 2007; 3. Ankesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit kundër Aktgjykimin të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2021/2007, të 29 korrikut 2010; si dhe, 4. Dokumentet tjera që mund të konsiderohen të rëndësishme lidhur me rastin.

9. Më 25 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti dokumentet e kërkuara nga Gjykata, duke bërë gjithashtu "plotësimin e kërkesës".
10. Më 2 gusht 2019, Gjykata njoftoi Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ta dorëzimin e komenteve, nëse kanë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.
11. Më 26 mars 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Fillimisht, Gjykata vë në dukje se kjo kërkesë është e ndërlidhur me rastin KI115/16, me parashtrues V. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj., rast ky i cili është vendosur përmes Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, KI115/16, të 29 majit 2018. Rrjedhimisht, Gjykata në vijim do t'i përmbledh edhe faktet e rastit KI115/16, për atë që lidhen me kërkesën aktuale (KI105/19).
13. Më 2 shkurt 1959, nëna e V. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj., kishte lidhur kontratën e shitblerjes Nr. vr. 570/60 (në testin e mëtejme: Kontrata e shitblerjes), me Kooperativën Bujqësore "Orloviq", për shitblerjen e ngastrës kadastrale me sipërfaqe prej 3.00.00 ha, njësia nr.1034 në Obiliq, fleta poseduese nr. 49.
14. Në vitin 2007, V. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj., kishin parashtruar dy padi të ndara: (i) më 14 gusht 2007 në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS); dhe, (ii) më 17 shtator 2007 në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Përmes këtyre dy padive, V. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj., kishin kërkuar që t'iu njihen të drejtat e pronësisë në lidhje me ngastrën kadastrale të cekur më lart dhe kontrata për shitblerjen e paluajtshmërisë të shpallet nule, si dhe të obligohet "Kosova Export" që atyre t'ua kthejë në pronësi këtë patundshmëri.
15. Më 20 nëntor 2007, DHPGJS, përmes Aktvendimit SCC-07-0322, e referoi në Gjykatën Komunale në Prishtinë padinë e V. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj.
16. Më 29 korrik 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë, përmes Aktgjykimit C. nr. 2021/2007, aprovoi kërkesëpadinë V. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj., dhe shpalli të pavlefshme (nule) kontratën përkatëse të shitblerjes në mes të paditësve (V. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj.) dhe Kooperativës Bujqësore "Orloviq". Kjo meqë, sipas Gjykatës Komunale, nuk ishte vërtetuar që ishte paguar çmimi i dakorduar me Kontratën e shitblerjes. Pasi që konstatoi se prona kontestuese evidentohet në emër të personit të tretë, Gjykata Komunale vendosi që KBI "Kosova Eksport" në Fushë-Kosovë, si trashëgimtar juridik i Kooperativës Bujqësore në Orloviq, detyrohet që paditësve V. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj., t'ua kthejë në pronësi disa parcela të tjera, në sipërfaqe prej gjithsej 3.00,00ha (ngastra kadastrale nr. 236/5; ngastra kadastrale nr. 236/2, si dhe ngastra kadastrale nr. 202/2.). Në këtë Aktgjykim, këshilla juridike përcaktonte se kundër Aktgjykimit në fjalë palët kanë të drejtë ankese në DHPGJS në afatin prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, nga dita e dorëzimit të Aktgjykimit.

17. Më 18 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës (AKP), duke vepruar si administrator i "Kosova-Export" e cila ishte pasardhëse e Kooperativës Bujqësore "Orloviq", paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 29 korrikut 2010. Më 26 nëntor 2010, Ndërmarrja Shoqërore "Ratar" poashtu parashtrroi ankesë kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
18. Më 11 shtator 2011, 22 korrik 2013 dhe 31 mars 2016, V. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj., parashtruan parashtrësia të veçanta në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së ku, ndër të tjera, kontestuan afatin ligjor të paraqitjes së ankesës nga ana e parashtruesit të kërkesës. Ata argumentuan se ankesa e AKP-së ishte paraqitur pas afatit, në bazë Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/ 4, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2002/13, Mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme në Gjykatën Supreme të Kosovës mbi çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: Rregullorja 2008/4) dhe se pranimi i ankesës së AKP-së, jo në përputhje me Rregulloren 2008/4, shkon kundër praktikës së deritanishme të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së lidhur me këtë çështje.
19. Më 21 prill 2016, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit AC-II-12-126, aprovoi ankesën e AKP-së dhe e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, duke refuzuar si të pabazuar padinë e V. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj. Kolegji i Apelit, në këtë Aktgjykim, kishte arsyetuar se:
- "Gjykata e shkallës së parë e aprovoi mjetin juridik i cili nuk ekziston si çështje e së drejtës. Nga kjo padi është e qartë se i padituri nuk është pronar i pasurive të patundshme që kishin qenë objekt i kontratës së vitit 1959. Pretendimi i një prone të ndryshme në vend të asaj fillestare, është ligjërisht i pamundur. Në raste të tilla - kur kontrata revokohet, anulohet, ose ndërpritet dhe i padituri nuk është pronar i objektit origjinal të kontratës në dispozicion është vetëm kompensimi monetar. Kështu, aktvendimi i ankimuar është i gabuar dhe duhet të prishet dhe padia të refuzohet si e pabazuar".*
20. Më 17 shtator 2016, V. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj., parashtruan kërkesën KI115/16 në Gjykatën Kushtetuese. Ata kontestuan kushtetutshmërinë e Aktgjykimit AC-II-12-126, të 21 prillit 2016, duke pretenduar se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nuk e kishte arsyetuar pretendimin e këtyre të fundit lidhur me afatshmërinë e parashtrimin të ankesës nga ana e AKP-së, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale.
21. Më 29 maj 2018, Gjykata Kushtetuese shpalli të pranueshme kërkesën KI 115/16, të V. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj.; konstatoi se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-II-12-0126, i 21 prillit 2016, kishte shkaktuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-II-12-0126, të 21 prillit 2016; dhe ktheu Aktgjykimin në fjalë në rishqyrtim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së.

22. Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin e saj KI115/16, ndër të tjera, kishte theksuar:

“Arsyetimi i Kolegjit të Apelit, në fakt, dështon të trajtoj çështjen e pranueshmërisë së ankesës së AKP-së dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës për paaftshmërinë e saj [...] Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron që pretendimet përkitazi me afatshmërinë e ankesës së AKP-së kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në bazë të legjislacionit të aplikueshëm dhe praktikës gjyqësore të Kolegjit të Apelit janë pretendime dhe argumente thelbësore të parashtruesve të kërkesës e të cilat duhet të adresohen dhe të arsyetohen nga Kolegji i Apelit”.

23. Më 14 shkurt 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, duke vepruar në rigjykim në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KI115/16, përmes Aktvendimit AC-II-12-0126, e hodhi poshtë si të papranueshme ankesën e AKP-së. Kolegji i Apelit fillimisht vendosi “të përjashtojë pjesën gojore të seancës” bazuar në nenin 64, paragrafi 1 të shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033. Më tej, Kolegji i Apelit, duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës KI115/16, theksoi se:

*“Kolegji i Apelit vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë i datës 29 korrik 2010, është pranuar nga AKP-ja me datë **30 shtator 2010**, ndërsa ankesa e paraqitur nga AKP-ja ndaj këtij Aktgjykimi është dorëzuar në DHPGJS me datën **18 nëntor 2010**, në ditën e **49** pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale. Aktgjykimi i Ankimuar i Gjykatës Komunale në Prishtinë, e ka udhëzimin juridik sipas të cilit ankesa ndaj këtij Aktgjykimi duhet të dorëzohet në afatin prej 60 ditëve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nëpërmes kësaj Gjykate.*

Në bazë të nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/4 mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme është paraparë se: ‘Aktgjykimi apo vendimi i Panelit Gjykues i dërgohet palëve brenda tridhjetë (30) ditësh nga miratimi. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e tij pala mund të paraqesë ankesë në Panelin e Apelit për rishqyrtim të Aktgjykimit apo vendimit të tillë...’

Në bazë të nenit 59 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2008/6 të datës 11 qershor 2008, është paraparë që neni 59.1 Ankesa parashtrohet në Dhomën e Posaçme brenda dy muajve prej datës kur i dorëzohet aktgjykimi palës që ankohet’

Të dy aktet e cekura ligjore ishin në zbatim në kohën e nxjerrjes së Aktgjykimit të ankimuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

Ankesa e AKP-së konsiderohet si e paaftshme pasi që përlllogaritja e afatit është bërë në bazë të nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2008/4, si akt më i lartë juridik në hierarkinë e akteve ligjore, e jo në bazë të nenit 59.1 të urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2008/06, që është një akt më i ulët se Rregullorja në fjalë. Sipas kësaj rregulloreje

afati ligjor për parashtrimin e ankesës është 30 ditë ndërsa ankesa është e qartë se është parashtruar pas afatit ligjor [...] Gjykata Kushtetuese në pikën e 45-të të Aktvendimit për papranueshmëri në rastin nr. KI145/13 vlerëson se ‘mbështetja e parashtruesit në këshillën e Gjykatës Komunale lidhur me kohëzgjatjen e afatit ligjor brenda të cilit një ankesë e mundshme mund të dorëzohet nuk mund të shërbej si zëvendësim për përputhshmërinë me një dispozitë të qartë ligjore’.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe paragrafin 3 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij ngritë disa pretendime të ndërlidhura, të cilat Gjykata do t'i përmbledhë si në vijim:
 - (i) *Vendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së është i paarsyetuar dhe kundërthënës*
26. Parashtruesi i kërkesës fillimisht pretendon se arsyetimi i vendimit nuk është i bazuar në argumente ligjore dhe nuk është i mjaftueshëm dhe bindës.
27. Parashtruesi i kërkesës, më tej, thekson se përmes arsytimit të vendimit të kontestuar, Kolegji i Apelit ka kontribuar *“në krijimin e një praktike të re dhe të dëmshme në sistemin gjyqësor [...] gjatë arsytimit theksohet se në kohën e nxjerrjes së Aktgjykimit C.nr.2021/07 të Gjykatës Komunale ish-in në fuqi Rregullorja 2008/4 si dhe Urdhëresa Administrative 2008/06 të cilat kanë paraparë afate të ndryshme për paraqitjen e ankesës dhe se krejt në fund në dispozitiv të vendimit të kontestuar theksohet se në rastin e kësaj lënde zyrtarët ligjor të AKP-së duke mos qenë vigjilent sa duhet kanë lëshuar afatin ligjor të paraparë me rregulloren e UNMIK-ut 2008/4 e cila ishte në zbatim në kohën e nxjerrjes së Aktgjykimit të ankimuar, andaj ankesa e saj është dashur të hedhet poshtë si e papranueshme”.*
28. Sipas parashtruesit, *“ky pasus është në kundërshtim me pasusin e 3-të në fagen 8-të, të këtij aktvendimi në të cilin thuhet se edhe urdhëresa administrative e UNMIK-ut si dhe Rregullorja 2008/4 kanë qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së aktgjykimit nga gjykata komunale në Prishtinë [...]”.*
 - (ii) *Përbërja e trupit gjykues të DHPGJ-së, i cili kishte marrë pjesë në nxjerrjen e Aktvendimit AC-II-12-0126, të 14 shkurtit 2019, nuk ishte në përputhje me Ligjin nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme”.*
29. Lidhur me përbërjen e trupit gjykues në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, i cili kishte marrë pjesë në nxjerrjen e Aktvendimit AC-II-12-0126, të 14 shkurtit

2019, parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi për përbërjen e këtij trupi gjykues “është i bazuar në vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me nr. 197/2018 të nëntorit 2018 e jo në bazë të Ligjit 04/L-0033 për Dhomën e Posaçme [...] kjo mund të jetë edhe si arsye e vetme për prishjen e këtij aktvendimi me nr. AC.II-12-0126 të dt. 14.02.2019, në fakt edhe sipas praktikave në të gjitha gjykatat kur kthehet një çështje në rishqyrtim dhe rivendosje nuk mund të ketë të njëjtin, por është dashur që të ketë numër të ri”.

30. Më tej, parashtruesi i kërkesës deklaroi: “[...] kemi të bëjmë me aktgjykim të marrë nga gjykata inkompetente, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit të lartshënuar e cila ka qenë kompetencë ekskluzive e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Kjo Gjykatë në çfarëdo mënyre që ka ardhë në dijeni për mungesë juridiksioni ka pasur obligim që me një urdhër apo aktvendim ta shpall nule”.

(iii) Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KI115/16 është nxjerrë pa marrë mendimin e AKP-së lidhur me praktikën e DHPGJS-së

31. Lidhur me pretendimin përkitazi me vendimmarrjen në Gjykatën Kushtetuese në rastin KI115/16, parashtruesi deklaroi se: “Gjykata Kushtetuese [...] gjatë shqyrtimit të kërkesës së paditësve, [AKP-së] ja ka dërguar një njoftim, në atë kohë kemi telefonuar [...] ku pas verifikimit të gjendjes na është thënë të presim urdhrin për përgjigje si në rastet paraprake. Duke pritur urdhrin kemi pranuar aktgjykimin. [...] kjo konsiderohet shkelje e rregullave procedurale, vurja në lajthitje e palës”.

(iv) Aktvendimi i Kolegjit të Apelit mundësoi plotfuqishmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. Nr. 2021/07, të 20 korrikut 2010, aktgjykim ky i nxjerrë pa asnjë bazë ligjore”.

32. Parashtruesi fillimisht pohon se “Aktvendimi i Kolegjit të Apelit mundësoi plotfuqishmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2021/07, të 29 korrikut 2010, aktgjykim ky i nxjerrë pa asnjë bazë ligjore”.

33. Lidhur me efektet e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës thekson se: “Me transferimin e kësaj sipërfaqeje të rëndësishme të tokës në këtë mënyrë duke nuluar kontratën e vitit 1960 [...] është manifestuar shkelje e rëndë e të drejtave të punëtorëve të kësaj ndërmarrje shoqërore të cilëve do t’u takonte kompensimi i 20%”. Sipas parashtruesit të kërkesës, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, ka qenë e obliguar dhe ka qenë kompetente që në çfarëdo mënyre të jetë vënë në dijeni për ekzistimin e një vendimi të marrë nga ndonjë organ jo kompetent, qoftë përmes ankesës apo parashtrësë “ka pasur obligim që me një urdhër apo aktvendim ta shpallë nule”.

(v) Kolegji i Apelit nuk kishte mbajtur seancë dëgjimore me ç’rast do t’i mundësohej parashtruesit që të paraqiste qëndrimin e tij

34. Parashtruesi argumenton se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, duke vendosur në rigjykim, nuk ka mbajtur seancë dëgjimore dhe në këtë mënyrë nuk i është mundësuar parashtruesit të kërkesës që të paraqiste qëndrimin e vet. Lidhur me këtë, parashtruesi shtoi: *“Kolegji i Apelit, gjatë shqyrtimit të çështjes së kthyer në riprocedurë dhe rivendosje nuk e kanë pa të arsyeshme që me një urdhër të kërkojnë deklarimin apo mendimin e AKP-së, dhe për këtë Kolegji ka pasur mundësi të bëjë seancë dëgjimore, me ç’rast do merreshin opinionet e palëve në procedurë”*.

(vi) *Gjendja faktike e konstatuar me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit nuk është reale*

35. Parashtruesi në kërkesë thekson se arsyetimi hierarkik i akteve ligjore *“se rregullorja konsiderohet ligj, ndërsa urdhëresa administrative si akt nënligjor, nuk është i qëndrueshëm, për faktin se lidhur me këto akte ligjore ka mundur të bëjë interpretim vetëm zyra ligjore e UNMIK-ut [...] Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6 nuk mund që të interpretohet në pikëpamjen e validitetit hierarkik të saj. Sepse Rregullorja dhe urdhëresa ishin në fuqi dhe të zbatueshme po ashtu siç theksohet edhe në arsyetimin e vendimit të atakuar faqe VIII paragrafi i 4 [...] Ka edhe shumë ankesa që nga AKP-ja janë paraqitur në bazë të nenit 59.1 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6”*.

36. Më tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin konkret Kolegji i Apelit i DHPGJS-së është dashur që të marrë parasysh afatin e paraparë me Urdhëresën Administrative e cila ka rregulluar çështjen e delegimit të rasteve në shqyrtim tek gjykatat vendore *“dhe pikërisht për shkak të bartjes së juridiksionit nga Dhoma e Posaçme tek Gjykatat Komunale i ka paraparë afatin kohor për parashtrimin e ankesës prej 60 ditësh. Ndërsa gjatë kohës së zbatimit të këtyre dy akteve nuk është bërë ndonjë dallim në mes njërës dhe tjetrës dhe konsiderojmë se kjo urdhëresë administrative është dashur të zbatohet deri me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit për Dhomën e Posaçme[...]”*.

(vii) *Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI115/16, nuk është interpretuar në mënyrë të drejtë përmes Aktvendimit të Kolegjit të Apelit*

37. Përkitazi me këtë pretendim, parashtruesi argumenton se *“me aktvendimin e Kolegjit të Apelit AC-II-12-0126 [...] ky aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese interpretohet në mënyrën sesi i konvenon Kolegjit të Apelit duke ia mveshur edhe interpretimit hierarkik të akteve ligjore [...] Me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, hierarkia e akteve ligjore vetëm sa përmendet, ndërsa praktika gjyqësore është fakti në të cilën është bazuar në tërësi ky aktgjykim. Lidhur me këtë praktikë gjyqësore kemi shpresuar se edhe Gjykata Kushtetuese ka mund që të kërkojë nga Kolegji i Apelit elaborimin e këtyre dy rasteve të cilat po veçohen në këtë aktgjykim siç janë: AC-II-12-0126 dhe AC-II12-0120[...]”*.

38. Parashtruesi i kërkesës, krejt në fund, pretendon se *“Sipas Rregullores 2008/4 afati kohor prej 30 ditësh për paraqitjen e ankesës është afat i paraparë vetëm për aktgjykimet që vendosë Dhoma e Posaçme në shkallë të parë-*

Kolegj të Specializuar". Ndërsa, thekson se "Sipas Urdhëresës administrative 2008/6 afati kohor prej 60 ditësh për paraqitjen e ankesës është i paraparë vetëm për rastet e deleguara tek gjykatat tjera ose të rregullta në tërë Kosovën".

39. Në ndërlidhje me atë që u tha më lart, parashtruesi i kërkesës thekson se ka respektuar afatin e paraparë me nenin 59 të Urdhëresës Administrative 2008/6 dhe ka respektuar udhëzimin juridik të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale [C. nr. 2021/2007], dhe me këtë e ka ushtruar të drejtën për përdorimin e mjeteve juridike siç parashihet me nenin 32 të Kushtetutës.
40. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata: (i) të anulojë Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-II-12-0126, të 14 shkurtit 2019; dhe (ii) Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2021/2007, të 19 korrikut 2010.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

(...)

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

(...)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

(...)

**LIGJI NR. 04/L-033 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS
SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË
KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

Neni 3

Përbërja, organizimi dhe emërimi

12. Kolegji i Apelit do të përbëhet nga pesë (5) gjykatës, tre (3) nga të cilët do të jenë gjykatës ndërkombëtarë dhe dy (2) do të jenë shtetas të Kosovës. Kryetari i Dhomës së Posaçme do të shërbejë si kryesues i Kolegjit të Apelit. Katër (4) anëtarët tjerë të Kolegjit të Apelit do të caktohen nga Kryetari i Dhomës së Posaçme pas konsultimit me Presidentin e Kosovës dhe Misionin Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes.

Neni 4

Juridiksioni

[...]

4. Që prej hyrjes në fuqi të këtij ligji, as Dhoma e Posaçme, e as kolegjet apo gjyqtarët e saj, nuk do të kenë asnjë autoritet për t'i referuar ndonjë kërkesë, lëndë, procedurë apo rast specifik që është kompetencë primare e tyre tek gjykatat tjera të Kosovës. Për secilën kërkesë, lëndë, rast apo procedurë (bashkërisht të emëruara më tutje në tekst si: "lëndë") të referuar si të tilla para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji: (i) nëse gjykata tek e cila është referuar lënda, nuk ka marrë ndonjë Aktvendim substancial në lidhje me atë lëndë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ajo gjykatë pushon së pasuri kompetencë mbi lëndën dhe i kthen të gjitha dokumentet dhe shkresat e lëndës tek Dhoma e Posaçme; (ii) nëse gjykata tek e cila është referuar lënda, ka marrë Aktvendim substancial në lidhje me atë lëndë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ajo gjykatë vazhdon të ketë kompetencë mbi lëndën, derisa aktvendimet dhe aktgjykimet në lidhje me atë lëndë i nënshtrohen shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme me kushtin e parashtrimit me kohë të parashtrësës nga pala apo pala e tretë e prekur; (iii) nëse gjykata tek e cila është referuar lënda, ka nxjerrë Aktgjykim në lidhje me atë lëndë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ai Aktgjykim i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme me kushtin e parashtrimit me kohë të parashtrësës nga pala apo pala e tretë e prekur; por me kusht që nëse Dhoma e Posaçme hedh poshtë atë Aktgjykim, plotësisht apo pjesërisht, lënda (ët) në fjalë do të nënshtrohen rigjyqimit para Kolegjit të Specializuar të asaj lënde, e jo në gjykatën që ka lëshuar Aktgjykimin. Nëse Agjencia nuk është emëruar si palë në ndonjë lëndë që është në punë në ndonjë gjykatë sipas këtij paragrafi, gjykata në fjalë do të jetë e obliguar të emërojë Agjencinë si palë, ndërsa Agjencia do të ketë të drejtë të marrë pjesë plotësisht në lëndë si palë ex officio, si dhe do të marrë kopjen e plotë të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe do t' i dorëzohen të gjitha parashtrësat, aktvendimet dhe aktgjykimet me shkrim, të parashtruara apo lëshuara në të ardhmen në atë lëndë apo procedurë. Nëse lënda është në shqyrtim e sipër në një gjykatë tjetër, ajo gjykatë nuk do të ketë autoritet

si dhe nuk do të lëshojë asnjë Aktgjykim apo Aktvendim që do të shkelte apo do të ishte në mospërputhje me kufijtë e caktuar me nenin 11 të këtij Ligji.

5. Asnjë gjykatë në Kosovë, përveç Dhomës së Posaçme, nuk do të ketë kompetencë apo autoritet mbi asnjë kërkesë, lëndë, procedurë apo rast të përshkruar me paragrafin 1 të këtij neni, përveç atyre që në mënyrë të veçantë përcaktohen në paragrafin 4 më lart. Nëse një gjykatë ka ushtruar apo ka provuar të ushtrojë kompetencë apo autoritet mbi një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast në kompetencën e Dhomës së Posaçme, derisa një lëndë apo kërkesë e tillë nuk është brenda kompetencës së asaj gjykate sipas paragrafit 4:

5.1.çdo Aktgjykim apo Aktvendim i lëshuar nga një gjykatë e tillë në lidhje me një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast, do të jenë të pavlefshme dhe të papërmbarueshme; ndërsa Dhoma e Posaçme, në bazë të parashtrësës së një personi, apo me iniciativën vetanake, do të lëshojë një urdhër me atë fuqi;

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me 1 janar 2012.

SHTOJCA E LIGJIT Nr. 04/L-033 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 64 Procedurat e ankesës me gojë

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.

[...]

UNMIK / Rregullore / 2008/4 e 5 shkurtit 2008 PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2002/13 MBI THEMELIMIN E DHOMËS SË POSAÇME NË GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS MBI ÇËSHTJET QË KANË TË BËJNË ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT

[.. .]

Neni 9 - Aktvendimet, vendimet dhe ankesat
Neni 9.5

Aktgjykimi apo vendimi i panelit gjykues i dërgohet palëve brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga miratimi. Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e tij

pala mund të paraqesë ankesë në panelin e apelit për rishqyrtim të aktgjykimit apo vendimit të tillë.

[...]

URDHËRESA ADMINISTRATIVE E UNMIK-UT 2008/6 E 11 KORRIKUT 2008 E CILA NDRYSHON DHE IMPLEMENTON URDHËRESËN ADMINISTRATIVE 2006/17, QË IMPLEMENTON RREGULLOREN E UNMIK-UT 2002/13 MBI THEMELIMIN E ODËS SË VEÇANTË TË GJYKATËS SUPREME PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT

[...]

Neni 59
Paraqitja e ankesës

59.1 Ankesa duhet të paraqitet në Dhomën e Posaçme në afat prej dy muaj nga dita e dorëzimit të aktgjykimit të pala e cila paraqet ankesë.

RREGULLORE NR. 2002/13-UNMIK/RREG/2002/13 e 13 qershorit 2002 MBI THEMELIMIN E DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË E MIRËBESIMIT TË KOSOVËS

Neni 4
JURIDIKSIONI

4.1 Dhoma e Posaçme ka juridiksion parësor për paditë dhe kundërpaditë që lidhen me:

(a) Kundërshtimet ndaj vendimeve ose veprimeve të tjera të Agjencisë, të marra në përputhje me Rregulloren nr. 2002/12, duke përfshirë shqiptimin e gjobave, siç është përcaktuar në nenin 27, të Rregullores nr. 2002/12;

(b) Paditë kundër Agjencisë, për dëmet financiare që rezultojnë nga vendimet apo veprimet e marra, në përputhje me rolin e saj si administruese e një ndërmarrjeje apo korporate;

(c) Paditë, duke përfshirë paditë e kreditorëve ose paditë pronësore, të bëra kundër një ndërmarrjeje apo korporate, që aktualisht është ose ka qenë më parë, nën autoritetin administrativ të Agjencisë, kur këto padi kanë lindur gjatë, ose para se ndërmarrja apo korporata e tillë t'i jetë nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë;

(d) Paditë që përfshijnë njohjen e një të drejte, një titulli apo interesi pronësor, që është në posedim apo nën kontrollin e një ndërmarrjeje a korporate, që aktualisht është ose ka qenë më parë nën autoritetin administrues të Agjencisë, kur paditë e tilla kanë lindur gjatë kohës ose para kohës, kur ndërmarrja apo korporata e tillë, i është nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë;

(e) Zbatimin, me kërkesën e Agjencisë, të kompetencave të Agjencisë, të ushtruara në përputhje me Rregulloren nr. 2002/12;

(f) Paditë për anulimin e transaksioneve të ndonjë ndërmarrjeje me pronësi shoqërore, që i është nënshtruar procedurës së likuidimit, siç është paraparë në nenin 9.4, të Rregullores nr. 2002/12 dhe

(g) Çështje të tjera të tilla që mund t'i caktohen me ligj.

4.2 Pavarësisht nga neni 4.1, Dhoma e Posaçme mund t'ia përcjellë paditë e veçanta, kategoritë e padive ose pjesë të tyre, cilëndo gjykate që ka juridiksion për atë çështje sipas ligjit në fuqi. Asnjë gjykatë në Kosovë, nuk mund të ushtrojë juridiksion për ndonjë padi që përfshin lëndën e përshkruar në nenin 4.1, përveç nëse një padi e tillë, i është përcjellur asaj në pajtim me këtë nen.

[...]

**URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2006/17 e 6 dhjetorit 2006
PËR NDRYSHIMIN DHE ZËVENDËSIMIN E URDHËRESËS
ADMINISTRATIVE TË UNMIK-ut NR. 2003/13, PËR ZBATIMIN E
RREGULLORES NR. 2002/13 PËR THEMELIMIN E DHOMËS SË
POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET
QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT**

Neni 17
Referimi i kërkesëpadive

17.1 Në pajtim me nenin 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13, pas kërkesës së palës ose me propozimin e vet, Dhoma e Posaçme mund të urdhërojë që një kërkesëpadi specifike ose një pjesë e saj t'i referohet një gjykate që ka juridiksion për atë çështje sipas ligjit në fuqi në rastet kur:

(a) Të gjitha palët kanë konfirmuar me shkrim se pajtohen për çështjen e referuar në atë mënyrë ose

(b) Dhoma e Posaçme është e kënaqur se gjykata së cilës i referohet kërkesëpadia do të sjellë vendim të paanshëm duke pasur parasysh:

(i) natyrën e palëve;

(ii) vlerën e shumës kundërthënëse; dhe

(iii) rrethanat tjera të kërkesëpadisë.

17.2 Vendimi që i referohet një çështjeje sipas nenit 17.1 bëhet me shkrim dhe duhet t'i theksojë arsyet e vendimit dhe të tregojë nëse ankesa duhet të regjistrohet te Dhoma e Posaçme apo te ndonjë gjykatë tjetër kompetente në Kosovë. Një vendim i tillë është obligues për palët dhe për gjykatën së cilës i referohet çështja.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

41. Gjkata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala autorizuar.

[...]

7. Individët janë autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

43. Gjykata, gjithashtu, i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: “Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.
44. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (Shih rastin e Gjykatës KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
45. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa Individuale]

“1: Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ”.

46. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin AC-II-12-0126, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, të 14 shkurtit 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike.

Parashtruesi i kërkesës i ka saktësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.

47. Përveç këtyre kritereve, në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës Gjykata duhet po ashtu t'i referohet edhe rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) i Rregullores përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

48. Për sa i përket rrethanave të rastit konkret, Gjykata fillimisht sjellë në vëmendje se Gjykata Komunale në Prishtinë kishte aprovuar padinë e B. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj. dhe kishte shpallur nule kontratën e shitblerjes, të lidhur nga e ëma e këtyre të fundit me Kooperativën Bujqësore “Orloviq” (në vitin 1959). Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës në cilësi të administratorit të ndërmarrjeve publike kishte parashtruar ankesë në Kolegj të Apelit të DHPGJS-së, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale. Në anën tjetër, personat e lartpërmendur përmes përgjigjes në ankesë, ndër të tjera, kishin pretenduar se ankesa e AKP-së ishte ushtruar jashtë afatit të paraparë në bazë Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/4. Kolegji i Apelit i DHPGJS-së aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës duke e anuluar aktgjykimin e Gjykatës Komunale, ndërsa pretendimet e B. Lj., R. Lj. dhe A. V. Lj., lidhur me afatshmërinë e ankesës së AKP-së, nuk i trajtoi fare. Personat e lartcekur parashtruan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese e cila u regjistrua me numër KI115/16, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, duke theksuar se pretendimet e tyre nuk ishin adresuar. Gjykata Kushtetuese vendosi që kërkesa ishte e pranueshme, duke konstatuar se: (i) ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; (ii) shpallet i pavlefshëm Aktgjykimi AC-II-12-0126, i 21 prillit 2016, i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së; (iii) ta kthejë Aktgjykimin e kontestuar në rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin KI115/16. Pas këtij Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, duke vendosur në rigjykim, e hodhi poshtë si të papranueshme ankesën e parashtruesit të kërkesës, sepse e konsideroi të parashtruar pas afatit 30 (tridhjetë) ditor.

49. Në dritën e këtyre rrethanave, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së i ka shkelur atij të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës. Parashtruesi, gjithashtu, pretendon se vendimi i kontestuar ka shkelur paragrafin 3 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.

50. Gjykata vë në pah se, në thelb, pretendimet e parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me shkeljen e pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm]. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se disa nga pretendimet e tij, të paraqitura ndaras, parashtruesi i mbështetë mbi të njëjtat argumente dhe arsytetime. Prandaj, Gjykata në vazhdim pretendimet e parashtruesit do t'i shqyrtojë ndaras, për aq sa ato mund të trajtohen ndaras,

ndërsa pretendimet të cilat konsideron se mund të grupohen do t' i trajtojë së bashku.

51. Si rrjedhojë, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit, në substancë, mund të grupohen si në vijim: (i) vendimi i kontestuar nuk është i arsyetuar, është kundërthënës dhe pa mbështetje ligjore dhe se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, për shkak të interpretimit të gabuar të afatit kohor për paraqitjen e ankesës në Kolegj të Apelit të DHPGJS-së; (ii) përbërja e trupit gjykues të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së nuk ishte në përputhje me Ligjin nr. 04/L-033 për Dhomen e Posaçme; (iii) Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nuk kishte mbajtur seancë dëgjimore me ç'rast do t' i mundësohej parashtruesit që të paraqiste opinionin e tij dhe se Aktvendimi i Kolegjit të Apelit është nxjerrë pa marrë mendimin e AKP-së lidhur me praktikën e DHPGJS-së; (iv) përmes vendimit të kontestuar arrihet plotfuqishmëria e vendimit joligjor të Gjykatës Komunale në Prishtinë; dhe, (v) Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI115/16, nuk është interpretuar në mënyrë të drejtë përmes Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.
52. Gjykata vëren se, përveç pretendimeve që kanë të bëjnë me vendimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, parashtruesi ngritë pretendime edhe lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, KI115/16, për të cilin pretendon se është nxjerrë pa marrë mendimin e AKP-së lidhur me praktikën e DHPGJS-së.
53. Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, të cekura në paragrafët e mësipërm, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës së vet gjyqësore, si dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
 - i) ***Përkitazi me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nuk ishte reale***
54. Lidhur me këtë pretendim, parashtruesi pohon se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, në arsyetimin e vendimit të kontestuar, kishte theksuar se Rregullorja 2008/4 dhe Urdhëresa administrative 2008/6 ishin në fuqi dhe të zbatueshme në kohën e nxjerrjes së Aktgjykimit C. nr. 2021/07 nga Gjykata Komunale. Në këtë drejtim, parashtruesi argumenton se: (i) nuk pajtohet me arsyetimin hierarkik që i është bërë Rregullores në raport me Urdhëresën Administrative, sepse, sipas tij, Urdhëresa ka rregulluar fushën e çështjes së delegimit të rasteve kur bartet juridiksioni i DHPGJS-së tek Gjykata Komunale. Prandaj, afati për paraqitje të ankesës duhej të ishte 60 (gjashtëdhjetë) ditë; (ii) Rregullorja 2008/4 parasheh afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh vetëm në aktgjykimet kur vendosë Dhoma e Posaçme në shkallë të parë-Kolegj të Specializuar; (iii) Urdhëresa Administrative është zbatuar gjithnjë nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së dhe parashtruesi i kërkesës thekson se i është përmbajtur kësaj dhe këshillës juridike në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale [C. nr. 2021/2007].

55. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vë në dukje se argumenti kryesor i parashtruesit për të mbështetur pretendimin për vendim të paarsyetuar dhe kundërthënës, si dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike, është se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ka bërë interpretime të gabuara të Rregullores 2008/4 dhe Urdhëresës Administrative 2008/6, duke i vendosur ato gabimisht në pozitë hierarkike (përkitazi me afatin për paraqitjen e ankesave në DHPGJS). Si pasojë, sipas tij, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ka konstatuar gabimisht se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur ankesë të paafatshme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, C. nr. 2021/7.
56. Për sa i përket çështjes së arsytimit të vendimeve gjyqësore – si element qenësor i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm – Gjykata fillimisht referohet në praktikën e pasur të GJEDNJ-së. Kështu, sipas GJEDNJ, gjykatat duhet “të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat mbështesin vendimet e tyre” (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33). Një standard i tillë është vendosur edhe me praktikën e pasur gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, duke përfshirë vendimet: KI97/16, parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim i 17 majit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019; KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019; KI123/19, parashtrues “*SUVA Rechtsabteilung*”, Aktgjykim i 13 majit 2020.
57. Më tutje, duke u referuar në praktikën e GJEDNJ-së, edhe Gjykata Kushtetuese, në një mori rastesh, ka theksuar se gjykatat e rregullta nuk janë të detyruara të adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga palët në procedurë. Megjithatë, GJEDNJ, sikundër edhe Gjykata Kushtetuese, kanë theksuar në vazhdimësi se gjykatat e rregullta kanë për detyrim të adresojnë pretendimet qendrore të palëve, për rastet para tyre (shih, *mutatis mutandis*, rastin e sipërcekur të Gjykatës Kushtetuese KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 53). Në këtë aspekt, e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, si në nivelin procedural ashtu edhe në atë material (shih *mutatis mutandis* rastin e sipërcekur të Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 54, KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 majit 2018, paragrafi 54; shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së: *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006).
58. Gjykata rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se vendimet e gjykatave do të shkelin parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Shih, ndër të tjera, vendimet e Gjykatës Kushtetuese: KI72/12, parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, cituar më lart, paragrafi 61; KI135/14, parashtrues *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 58; KI87/18 parashtrues *IF Skadeforsikring*, paragrafi 49; KI35/18,

parashtrues: “*Bayerische Versicherungsverband*”, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 59).

59. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht rikujton që Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ka nxjerr vendimin e kontestuar në rigjykim, pas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KI115/16. Siç u shpjegua më lart, në rastin KI115/16, Gjykata Kushtetuese vendosi që kërkesa ishte e pranueshme dhe konstatoi se: (i) kishte shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; (ii) shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin AC-II-12-0126 të 21 prillit 2016, të Kolegjit të Apelit; (iii) ktheu Aktgjykimin e kontestuar në rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin KI115/16.
60. Gjykata rikujton se në Aktgjykimin e saj KI115/16, ajo kishte theksuar se *“përfundimi i saj ka të bëjë ekskluzivisht me Aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së në atë rast, nga perspektiva e mungesës së arsytimit lidhur me pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës në atë rast, dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit”* (shih paragrafin 56, të rastit KI115/16). Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtruesve të kërkesës në rastin KI115/16 ishte se Kolegji i Apelit nuk ishte përgjigjur në pretendimet e tyre për afatshmërinë e ankesës.
61. Pra, Gjykata dëshiron të vë theksin në faktin se në Aktgjykimin e saj në rastin KI115/16, Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar vetëm pretendimin kryesor të parashtruesve të kërkesës në atë rast (B. Lj. R. Lj. dhe A. V.-Lj.). Gjykata sjellë në vëmendje se pretendimi kryesor i parashtruesve të kërkesës në atë rast ishte se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nuk kishte shqyrtuar fare pretendimin e tyre kryesor të paraqitur në përgjigje në ankesën e AKP-së, se ankesa e AKP-së ishte ushtruar jashtë afatit të paraparë në bazë Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/4. Së këndejmi, Gjykata e ka bërë të qartë se Aktgjykimi KI115/16 nuk paragjykon meritat e rastit, që do të thotë nuk është përcaktues për mënyrën sesi Kolegji i Apelit i DHPGJS-së bënë interpretimet e rregullativës përkatëse ligjore për të përcaktuar afatin e parashtrimit të ankesës nga ana e AKP-së, në rastin konkret.
62. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, duke vendosur në rigjykim, gjatë adresimit të të gjeturave të Aktgjykimit KI115/16 të Gjykatës Kushtetuese, vendosi që ankesën e AKP-së (parashtruesit të kërkesës) ta hedhë poshtë si të papranueshme.
63. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Aktvendimit AC-II-12-0126, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, të 14 shkurtit 2019, ku, ndër të tjera, theksohet se: *“Duke vepruar në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Kolegji i Apelit me këtë Aktvendim do t'i adresojë dhe do t'i arsyetojë pretendimet e paditësve lidhur me paafatshmërinë e ankesës të AKP-së të paraqitur ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komonale në Prishtinë, C.nr.2021/2007 datë 29.07.2010 [...]. Kolegji i Apelit vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Prishtinë i datës 29.07.2010, është pranuar nga AKP-ja me datë 30 shtator 2010, ndërsa ankesa e paraqitur nga AKP-ja ndaj këtij Aktgjykimi është dorëzuar në DHPGJS me*

datë 18 nëntor 2010, në ditën e 49 [...] Aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Komunale në Prishtinë, e ka udhëzimin juridik sipas të cilit ankesa ndaj këtij Aktgjykimi duhet të dorëzohet në afatin prej 60 dite[...] Në këtë lëndë Kolegji i Apelit ka vërejtur se ankesa e AKP-së, ishte e paafatshme, pasi që nuk ishte dorëzuar në afatin ligjor të përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4 [...] Ankesa e AKP-së konsiderohet e paafatshme pasi që përlllogaritja e afatit është bërë në bazë të nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, si akt më i lartë juridik në hierarkinë e akteve ligjore, jo në bazë të nenit 59.1 të Urdhëresës Administrative”.

64. *Më tutje, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së kishte shtuar se “Kjo linjë e pikëpamjes ligjore e Kolegjit të Apelit lidhur me afatin e paraqitjes së ankesës ndaj vendimeve të Gjykatës Komunale është ndjekë edhe në rastin e lëndës së mbyllur AC-II-12_0120. Rasti në fjalë ishte objekt i shqyrtimit edhe në Gjykatë Kushtetuese përmes Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI 145/13”.*
65. *Kolegji i Apelit iu referua dhe çështjes së kompetencës duke arsyetuar se “Së pari është e vërtetë se Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr.2008/6 në nenin 59.1 përcakton një afat prej dy muajsh [...] të paraqitet ankesa kundër vendimeve të Gjykatave Komunale, mirëpo kjo kompetencë ishte bartur nga Dhoma e Posaçme, ndërsa Dhoma e Posaçme nuk mund të bartë më shumë kompetencë se që ka vet”.*
66. *Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me praktikën e ndjekur lidhur me afatshmërinë e ankesave nga DHPGJS-së në rastet tjera, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur këtë pretendim. Për më tepër, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së ka argumentuar se “kjo linjë e pikëpamjes ligjore e Kolegjit të Apelit lidhur me afatin e paraqitjes së ankesës ndaj vendimeve të Gjykatës Komunale është ndjekë edhe në rastin e lëndës së mbyllur AC-II-12_0120. Rasti në fjalë ishte objekt i shqyrtimit edhe në Gjykatë Kushtetuese përmes Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI145/13”.*
67. *Gjykata e konsideron të rëndësishme të referohet edhe në Aktvendimin e saj në rastin KI145/13, të cilit i është referuar Kolegji i Apelit i DHPGJS-së. Gjykata sjellë në vëmendje ngjashmërinë e rastit KI145/13, me rastin aktual. Edhe në atë rast AKP, si parashtruese e kërkesës në Gjykatë Kushtetuese, ankohej se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së kishte shkaktuar shkelje kushtetuese kur kishte konstatuar se AKP nuk e ka paraqitur ankesën kundër vendimit të Gjykatës Komunale, brenda afatit të përcaktuar me Rregulloren 2008/4.*
68. *Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese, në Aktvendimin e saj për papranueshmëri KI145/13, theksoi se:*

“[...] Mbështetja e parashtruesit (AKPS-së) në këshillën e Gjykatës Komunale lidhur me kohëzgjatjen e afatit ligjor brenda të cilit një ankesë e mundshme mund të dorëzohet nuk mund të shërbejë si zëvendësim për përputhshmëri me një dispozitë të qartë ligjore. Një dispozitë e tillë është

dhënë nga ligjvënësi për qëllim të sigurisë ligjore duke i dhënë kështu mundësi palëve që të njohin të drejtat e tyre për ankesë dhe kohëzgjatjen e afateve ligjore për dorëzimin e ankesës [...] Gjykata më tutje vlerëson se ishte detyrë e parashtruesit të dijë afatin përfundimtar për të parashtruar ankesë. Duke u mbështetur në këshillën e gabuar për mjetin juridik nga ana e Gjykatës Komunale, ai ka dështuar të ushtrojë kujdes të nevojshëm dhe nuk mund të tregojë argumente të arsyeshme që do të falnin dështimin për të respektuar afatin e saktë përfundimtar të paraparë me dispozitën e duhur ligjore,” (shih paragrafët 45 dhe 46 të Aktvendimit KI145/13).

69. Më tutje, Gjykata vë në dukje, edhe një herë, se në pretendimet përkitazi me (mos)arsyetimin e vendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së dhe konstatimin “joreal” të gjendjes faktike, parashtruesi ngritë çështje të ligjshmërisë.
70. Gjykata thekson qëndrimin e saj konsistent se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me mënyrën sesi gjykatat e rregullta kanë bërë konstatimet e gjendjes faktike dhe interpretimet përkatëse ligjore (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa interpretimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo nuk mund të vlerësojë arsyen që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim, në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata Kushtetuese do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, ndër të tjera, aktvendimet e Gjykatës Kushtetuese: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Bestar Hima*, të 16 dhjetorit 2011; KI144/18, parashtrues: *Jashar Krasniqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 dhjetorit 2020).
71. Si përfundim, Gjykata gjen se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së është i qartë dhe adreson pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës. Nuk ka ndonjë argument apo pretendim thelbësor të cilin Kolegji i Apelit i DHPGJS-së e ka lënë mënjanë, si të paarsyetuar, siç pretendon parashtruesi i kërkesës.
72. Prandaj, Gjykata konstaton se arsyetimi i dhënë nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së plotëson standardet e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për një vendim gjyqësor të arsyetuar, sikurse janë shtjelluar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së.

ii) Përkitazi me pretendimin e parashtruesit për përbërjen e trupit gjykues

73. Lidhur me përbërjen e trupit gjykues i cili kishe marrë pjesë në nxjerrjen e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-II-12-0126, të 14 shkurtit 2019, Gjykata rikujton edhe një herë pretendimin e parashtruesit të kërkesës se: “përbërja e trupit gjykues është i bazuar në vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës e jo në bazë të Ligjit 04/L-0033 për *Dhomën e Posaçme* [...] kjo mund

të jetë edhe si arsye e vetme për prishjen e këtij aktvendimi [...] sipas praktikave në të gjitha gjykatat kur kthehet një çështje në rishqyrtim dhe rivendosje nuk mund të ketë të njëjtin, por është dashur që të ketë numër të ri”.

74. Gjykata vëren se këtë pretendim parashtruesi përveç që e ka përmendur si fakt, nuk e ka elaboruar më tutje se si përbërja e trupit gjykues nuk ishte e përbërë sipas Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme dhe, për më tepër, pse ky fakt ka shkaktuar shkelje kushtetuese. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me asnjë argument këtë pretendim të tij.
75. Prandaj, Gjykata vlerëson se ky pretendim i parashtruesit refuzohet si i pambështetur dhe rrjedhimisht i pabazuar.

iii) Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore dhe se Aktvendimi i Kolegjit të Apelit i bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI115/16, është nxjerrë pa marrë mendimin e AKP-së lidhur me praktikën e DHPGJS-së

76. Gjykata vë në pah pretendimin e parashtruesit se “Kolegji i Apelit, gjatë shqyrtimit të çështjes së kthyer në riprocedurë dhe rivendosje nuk e kanë pa të arsyeshme që me një urdhër të kërkojnë deklarimin e AKP-së, dhe për këtë Kolegji ka pasur mundësi të bëjë seancë dëgjimore, me ç’rast do merreshin opinionet e palëve në procedurë
77. Në lidhje me këtë, Gjykata referohet në praktikën e pasur të GJEDNJ-së lidhur me këtë çështje. Kështu, GJEDNJ ka theksuar në vazhdimësi se, përderisa dëgjimi publik përbën një parim themelor të parashikuar në nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së, detyrimi për të mbajtur një seancë të tillë nuk është absolut (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *De Tommaso kundër Italisë*, kërkesa nr. 43395/09, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafi 163; si dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese KI85/19, parashtrues: *Bujar Shabani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020, paragrafi 82).
78. GJEDNJ, sikundër edhe Gjykata Kushtetuese, kanë mbajtur qëndrim konsistent se mungesa e seancës dëgjimore në shkallë të dytë ose të tretë mund të arsyetohet nga veçoritë e veçanta të procedurave në fjalë, me kusht që seanca dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë (shih rastin e GJEDNJ-së *Helmers kundër Suedisë*, kërkesa nr. 11826/85, Aktgjykim i 29 tetorit 1991, paragrafi 36; *Salomonsson kundër Suedisë*, kërkesa nr. 38978/97, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 36, si dhe shih rastin e Gjykatës KI181/19, KI182/19 dhe KI183/19, parashtrues *Fllanza Naka, Fatmire Lima dhe Lemar Masar Zhubi*, Aktgjykim i 27 janarit 2021, paragrafi 38). Kështu, proceset gjyqësore të ankesave që përfshijnë vetëm çështje të ligjit, jo me çështjet faktike, mund të përputhen me kërkesat e nenit 6 edhe pse parashtruesit nuk i është dhënë një mundësi për t’u dëgjuar personalisht nga Gjykata e Apelit (shih rastin e GJEDNJ-së *Miller kundër Suedisë*, kërkesa nr. 55853/00, Aktgjykim i 8 shkurtit 2005, paragrafi 30).

79. Prandaj, edhe Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ kanë theksuar se, për sa i përket detyrimit për mbajtjen e seancës dëgjimore, duhet të merren parasysh veçantitë e procedurave në gjykatat më të larta (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI85/19, parashtrues: *Bujar Shabani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020 paragrafi 83).
80. Përveç nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që justifikojnë përjashtimin e një seance dëgjimore, e drejta për një dëgjim publik sipas nenit 6, paragrafit 1 nënkupton një të drejtë për një seancë dëgjimore të paktën në një nivel të vendimmarrjes gjyqësore (shih lidhur me këtë, rastet e GJEDNJ: *Fischer kundër Austrisë*, kërkesa nr. 16922/90, Aktgjykim i 26 prillit 1995, paragrafi 44; *Salomonsson kundër Suedisë*, kërkesa nr. 38978/97, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 36; *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, paragrafi 190; si dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI85/19, paragrafi 84).
81. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së kishte arsyetuar se, bazuar në nenin 64, paragrafin 1 të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kishte vendosur të mos mbajë seancë dëgjimore.
82. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 64 të Ligjit në fjalë, i cili përcakton se:

*Neni 64
Procedurat e ankesës me gojë*

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.

83. Me këtë rast, Gjykata konsideron se vendosja e rastit nga ana e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së vetëm mbi bazën e dosjes së lëndës, është në përputhje me nenin 64, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-033 dhe nuk është në kundërshtim me parimet e përcaktuara në praktikën e GJEDNJ-së, të cilat i ka zbatuar në mënyrë konsekuente edhe Gjykata Kushtetuese.
84. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin lidhur me shkeljen e të drejtës për seancë dëgjimore.
- iv) Pretendimi se përmes vendimit të kontestuar arrihet plotfuqishmëria e vendimit joligjor të Gjykatës Komunale në Prishtinë**

85. Lidhur me efektet e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Me transferimin e kësaj sipërfaqeje të rëndësishme të tokës në këtë mënyrë duke nuluar kontratën e vitit 1960 [...] është manifestuar shkelje e rëndë e të drejtave të punëtorëve të kësaj ndërmarrje shoqërore të cilëve do t’u takonte kompensimi i 20%”*. Sipas parashtruesit të kërkesës, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, ka qenë e obliguar dhe ka qenë kompetente që në çfarëdo mënyre të jetë vënë në dijeni për ekzistimin e një vendimi të marrë nga ndonjë organ jokompetent, qoftë përmes ankesës apo parashtrëse *“ka pasur obligim që me një urdhër apo aktvendim ta shpallë nule”*.
86. Gjykata fillimisht vë në dukje se ky pretendim ngritë dy çështje: së pari, shkeljen e mundshme të të drejtave të punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore “Kosova Export” (lidhur me kompensimin prej 20% nga privatizimi i kësaj ndërmarrjeje) dhe, së dyti, paligjshmërinë e vendimit të Gjykatës Komunale.
87. Për sa i përket pretendimit për shkeljen e të drejtave të punëtorëve, Gjykata konsideron se ai pretendim nuk është elaboruar dhe argumentuar nga ana e parashtruesit. Për më tepër, Gjykata vë në dukje se nga shkresat e lëndës nuk është e qartë se a është ngritur çështja e kompensimit të punëtorëve, gjatë seancave të zhvilluara në Gjykatën Komunale dhe DHPGJS.
88. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon poashtu se *“është fjala për Aktgjykim të marrë nga Gjykata jokompetente [Gjykata Komunale], në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit nr. 04/L-033, dhe DHPGJS-ja, në çfarëdo mënyre që ka ardhur në dijeni për mungesë të juridiksionit, ka pasur obligim që me një urdhër apo aktvendim ta shpallë nule”*.
89. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës këtë pretendim e mbështetë duke u thirrur në nenin 102 të Kushtetutës.
90. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 102 të Kushtetutës, Gjykata vë në dukje qëndrimin e saj të përgjithshëm se nenet e Kushtetutës të cilat nuk përcaktojnë, drejtpërdrejtë, të drejtat dhe liritë themelore nuk kanë efekt të pavarur. Efekti i tyre vlen vetëm për *“gëzimin e të drejtave dhe lirive”* që garantohen me dispozitat e Kapitullit II [Të drejtat dhe Liritë Themelore] dhe III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës (Shih, në këtë aspekt, rastet e Gjykatës KI16/19, me parashtrues *Bejta Commerce*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 nëntorit 2019, paragrafi 42; dhe KI67/16, me parashtrues *Lumturije Voca*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 23 janarit 2017, paragrafi 128).
91. Gjykata rikujton se parashtruesi i ndërlidhë pretendimet për shkeljen e nenit 102 të Kushtetutës, me pretendimet lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës i referohet aplikimit të nenit 4, paragrafi 5 pika (1) të Ligjit nr. 04/L-033 të DHPGJS-së, duke pretenduar shkelje për arsye të marrjes së vendimit nga një gjykatë jokompetente.

92. Gjykata me këtë rast rikujton se neni 4 [Jurisdiksioni], paragrafi 5 pika (1), të Ligjit nr. 04/L-033 të DHPGJS-së, përcakton se:

5. Asnjë gjykatë në Kosovë, përveç Dhomës së Posaçme, nuk do të ketë kompetencë apo autoritet mbi asnjë kërkesë, lëndë, procedurë apo rast të përshkruar me paragrafin 1 të këtij neni, përveç atyre që në mënyrë të veçantë përcaktohen në paragrafin 4 më lart. Nëse një gjykatë ka ushtruar apo ka provuar të ushtrojë kompetencë apo autoritet mbi një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast në kompetencën e Dhomës së Posaçme, derisa një lëndë apo kërkesë e tillë nuk është brenda kompetencës së asaj gjykate sipas paragrafit 4:

93. Ndërsa, paragrafi 4 i Ligjit nr. 04/L-033 të DHPGJS-së, ndër të tjera përcakton:

“[...] nëse gjykata tek e cila është referuar lënda, ka nxjerrë Aktgjykim në lidhje me atë lëndë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ai Aktgjykim i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme me kushtin e parashtrimit me kohë të parashtrësës nga pala apo pala e tretë e prekur; por me kusht që nëse Dhoma e Posaçme hedh poshtë atë Aktgjykim, plotësisht apo pjesërisht, lënda (ët) në fjalë do t'i nënshtrohen rigjyqimit para Kolegjit të Specializuar të asaj lënde, e jo në gjykatën që ka lëshuar Aktgjykimin. Nëse Agjencia nuk është emëruar si palë në ndonjë lëndë që është në punë në ndonjë gjykatë sipas këtij paragrafi, gjykata në fjalë do të jetë e obliguar të emërojë Agjencinë si palë”.

94. Gjykata vëren se sipas Ligjit nr. 04/L-033 të DHPGJS-së, Aktgjykimi i një gjykate i nënshtrohet shqyrtimit nga DHPGJS “me kushtin e parashtrimit me kohë të parashtrësës nga pala apo pala e tretë e prekur. Gjithashtu, Ligji parasheh se “Nëse Agjencia nuk është emëruar si palë në ndonjë lëndë që është në punë në ndonjë gjykatë sipas këtij paragrafi, gjykata në fjalë do të jetë e obliguar të emërojë Agjencinë si palë,[...]”.

95. Me këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, me mosparaqitjen me kohë të ankesës, ka humbur tërë mundësinë e tij që Aktgjykimi i Gjykatës Komunale t'i nënshtrohet shqyrtimit nga DHPGJS, siç parashihet me pikën (iii) paragrafi 3 i nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-033 të DHPGJS-së.

96. Marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata përsëritë se ishte detyrë e parashtruesit të dijë afatin përfundimtar ligjor për të parashtruar ankesë. Sidomos duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës, AKP, është institucion publik që fushëveprimtari ka çështjet që lidhen me ndërmarrjet publike dhe procesin e privatizimit – çështje këto që bien nën juridiksionin gjyqësor të DHPGJS-së. Duke u mbështetur në këshillën e gabuar për mjetin juridik, të dhënë nga ana e Gjykatës Komunale, parashtruesi ka dështuar të ushtrojë kujdes të nevojshëm dhe nuk mund të tregoj argumente të arsyeshme që do të falnin dështimin për të respektuar afatin e saktë përfundimtar të paraparë me dispozitën përkatëse ligjore. Gjykata vë në dukje se një qëndrim të tillë Gjykata Kushtetuese e ka mbajtur edhe në rastin, KI145/13, të cekur më lart (me parashtrues: Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim i 24 marsit 2014, paragrafi 46).

97. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin se përmes vendimit të kontestuar arrihet plotfuqishmëria e vendimit joligjor të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

v) Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI115/16, nuk është interpretuar në mënyrë të drejtë përmes Aktvendimit të Kolegjit të Apelit

98. Gjykata sjellë në vëmendje pretendimin e parashtruesit se, “Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese interpretohet në mënyrën sesi i konvenon Kolegjit të Apelit duke ia mveshur edhe interpretimit hierarkik të akteve ligjore [...] Me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, hierarkia e akteve ligjore vetëm sa përmendet, ndërsa praktika gjyqësore është fakti në të cilën është bazuar në tërësi ky aktgjykim. Lidhur me këtë praktikë gjyqësore kemi shpresuar se edhe Gjykata Kushtetuese ka mund që të kërkoj nga Kolegji i Apelit elaborimin e këtyre dy rasteve të cilat po veçohen në këtë aktgjykim siç janë: AC-II-12-0126 dhe AC-II12-0120[...]”.

99. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vë në pah, edhe një herë (shih paragrafin 60, më lart), se në Aktgjykimin e saj KI115/16 ajo kishte theksuar qartë se përfundimi i saj ka të bëjë ekskluzivisht me Aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, përkitazi me mungesën e arsytimit lidhur me pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës në atë rast. Pra, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin KI116/16 nuk kishte të bënte me atë sesi duhet të interpretojë Kolegji i Apelit i DHPGJS-së aktet përkatëse ligjore në rrethanat e rastit konkret. Kjo nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, Gjykata Kushtetuese e ktheu çështjen në rigjykim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, pa paragjykuar se cili do ishte epilogu i rastit në DHPGJS, përkatësisht “pa paragjykuar rezultatin e meritave të rastit” (shih paragrafin 56, të rastit KI115/16).

100. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet i papranueshëm.

vi) Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KI115/16 është nxjerrë pa marrë mendimin e AKP-së lidhur me praktikën e DHPGJS-së

101. Lidhur me pretendimin përkitazi me vendimmarrjen në Gjykatën Kushtetuese, në rastin KI115/16, parashtruesi deklaroi se: “Gjykata Kushtetuese [...] gjatë shqyrtimit të kërkesës së paditësve, [AKP-së] ja ka dërguar një njoftim, në atë kohë kemi telefonuar [...] ku pas verifikimit të gjendjes na është thënë të presim urdhrin për përgjigje si në rastet paraprake. Duke pritur urdhrin kemi pranuar aktgjykimin. [...] kjo konsiderohet shkelje e rregullave procedurale, vurja në lajthitje e palës”.

102. Parashtruesi i referohet Aktgjykimit në fjalë të Gjykatës Kushtetuese në ndërlidhje me pretendimin e tij për jokushtetutshmërinë e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, të 14 shkurtit 2019.

103. Në këtë sfond, Gjykata dëshiron të theksojë, *obiter dictum*, se vendimet e saj janë përfundimtare dhe, si të tilla, nuk mund të apeloohen në procedura gjyqësore.
104. Sidoqoftë, Gjykata sqaron se ajo ka ndjekur procedurat standarde në rastin KI115/16, në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren. Kështu, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar më 9 nëntor 2016 për parashtrimin e kërkesës KI115/16 dhe kishte mundësinë e paraqitjes së komenteve, megjithatë nga shkresat e lëndës rezultoi se parashtruesi i kërkesës një gjë të tillë nuk e kishte bërë këtë.

Përfundim

105. Në kërkesën KI105/19, AKP, në cilësinë e parashtruesit të kërkesës, ngritë një numër pretendimesh që kanë të bëjnë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Duke analizuar thelbin e këtyre pretendimeve, Gjykata i grupoi ato si në vijim: (i) vendimi kontestuar nuk është i arsyetuar, është kundërthënës dhe pa mbështetje ligjore dhe se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, për shkak të interpretimit të gabuar të afatit kohor për paraqitjen e ankesës në Kolegj të Apelit të DHPGJS-së; (ii) përbërja e trupit gjykues të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së nuk ishte në përputhje me Ligjin nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme; (iii) Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nuk kishte mbajtur seancë dëgjimore me ç'rast do t'i mundësohej parashtruesit që të paraqiste opinionin e tij dhe se Aktvendimi i Kolegjit të Apelit është nxjerrë pa marrë mendimin e AKP-së lidhur me praktikën e DHPGJS-së; (iv) përmes vendimit të kontestuar arrihet plotfuqishmëria e vendimit joligjor të Gjykatës Komonale në Prishtinë; dhe, (v) Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI115/16, nuk është interpretuar në mënyrë të drejtë përmes Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.
106. Emëruesi i përbashkët i këtyre pretendimeve ka të bëjë me mënyrën sesi është bërë zbatimi i ligjeve përkatëse nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së (AC-II.-12-0126) dhe Gjykata Komonale në Prishtinë (C. nr. 2021/07), kundruall rrethanave të rastit në fjalë, i cili është vendosur përfundimisht me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-II.-12-0126.
107. Gjykata konsideroi se, në thelb, këto pretendime ngritin çështje të ligjshmërisë dhe parashtruesi nuk ka arritur t'i argumentojë ato në rrafsh kushtetues. Rrjedhimisht, Gjykata, duke u mbështetur edhe në praktikën e saj të mëparshme në raste të njëjta, konstatoi se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe si e tillë duhet të shpallet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.
108. Në fund, duke pasur parasysh se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-II.-12-0126, është nxjerrë në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI115/16, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë se në Aktgjykimin në fjalë Gjykata Kushtetuese është ndaluar vetëm

tek çështja e (mos) plotësimit të standardit të vendimit të arsyetuar gjyqësor, në Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-II-12-126, të DHPGJS të 21 prillit 2016. Në përputhje me fushëveprimin e saj, Gjykata Kushtetuese nuk përcakton mënyrën sesi gjykatat e rregullta, në këtë rast DHPGJS, bëjnë interpretimet përkatëse ligjore, kundruall rrethanave faktike të rasteve specifike – përveç kur argumentohet se një interpretim i tillë tërheqë shkelje kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 21.4, 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit si dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 26 mars 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi